

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Debate te "Ligjet" për Territorialen! PD kërkon 100 bashki, PS 46, Korreshi: Nuk po bëjmë byrek këtu - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/debate-te-ligjet-per-territorialen-pd-kerkon-100-bashki-ps-46-korreshi-nuk-po-bejme-byrek-ketu/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 10:23:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 10:04:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	098de65303025909bad52f83766d7777d51d0d22dea4ecd1b80736b142586c9
TEKSTI	ff9d073d140030ec29cb6c1caae8839b4caa6f773681a57d1056874dacef4813
PAMJA	38b05b301bdae316fa9cfb284c5d32e810cb21de6ace2171b16d27850b29238d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bc65a5b6e8710a12933c4880d1cc15167868d2839a9899d9fdc0bee9e9b1212a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	abea285c66b625fda61d55a4ce47e92e047f4e5aa34cb0aedb7a5ee71b2cb2e0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bc65a5b6e8710a12933c4880d1cc15167868d2839a9899d9fdc0bee9e9b1212a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Edi Rama SHBA Pagat e gjyqtarëve Rusia Maliq

POLITIKË | VENDI

Debate te “Ligjet” për Territorialen! PD kërkon 100 bashki, PS 46, Korreshi: Nuk po bëjmë byrek këtu

28 Shtator 2026 | 12:04

Komisioni i Ligjeve ka nisur shqyrtimin e nismës për hartën e re territoriale të vendit, me Partinë Socialiste që kërkon të ecë përpara me variantin për 46 bashki.

Në të njëjtën kohë, Partia Demokratike ka paraqitur një variant alternativ që parashikon 100 bashki. Opozita kërkon që edhe kjo nismë t'i nënshtrohet një raundi konsultimi publik, duke kundërshtuar procedurën e ndjekur nga mazhoranca.

Në komision, deputeti demokrat Oerd Bylykbashi akuzoi mazhorancën se po e çon më tej atë që ai e cilësoi si dështimin e reformës territoriale të vitit 2014.

“Nga keq, e çoni akoma më keq. Ne kemi propozuar kalimin në 100 bashki. Reforma 2014 ka sjellë erozion social dhe institucional. Kanë ikur njerëzit. Konsultimet tuaja publike me komunitetin janë false. Ju po e bëni si e do kryeministra. Duhet që bashkitë të mundin të qeverisin vendin në përditshmëri për qytetarët, edhe sikur të jenë 1 vit pa qeveri. Ju nuk jeni konsultuar me komunitetet”, deklaroi Bylykbashi.

Ai kërkoi që dy nismat të trajtohen në të njëjtën procedurë dhe që edhe propozimi i opozitës të kalojë përmes konsultimit publik.

“Nisma juaj dhe nisma jonë, duhet të bashkohen. Duhet të bëhet edhe për nismën tonë procedurën e konsultimit publik që bëtë për draftin tuaj. Ju vratë konsensus se donit të nxirrnit hartën tuaj me 46 bashki. Bashkoni nismën tuaj legjislative, bashkoni dy nismat dhe bëni procedurë të njëjtë”, tha deputeti demokrat.

Nga mazhoranca, kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja, deklaroi se procedura do të vijojë mbi projektligjin e paraqitur nga Partia Socialiste.

“Silleni nismën tuaj, kur ta kemi në tavolinë do flasim. Ky komision do të vijojë me shqyrtimin e projektligjit të sjellë nga Partia Socialiste”, u shpreh Manja.

Debate pati edhe nga deputeti demokrat Saimir Korreshi, i cili e ironizoi mënyrën dhe shpejtësinë me të cilën po trajtohet reforma.

“Po se Byrek është ky, nga ata të ngrirët që e fut në furrë e del për 4 minuta? Kjo nuk bëhet më një ditë. Edhe Diella me AI të kishte ardhur, nuk do ishte bërë. Nuk mund t'ua themi këtë shqiptarëve. Është dhe ky varianti ynë tjetër. I mirë i keq, le ta shohim. Duhet dëgjuar varianti tjetër”. deklaroi Korreshi.

LAJMI I FUNDIT

12:16 Përmbysset varka me emigrantë në Kanalin Anglez, 3 të vdekur

12:14 Bardhi pas deklaratës së Ramës për Hysenin: Dil dhe jep llogari

12:09 Kremli: Ukraina po paguan çmimin për sulmet ndaj Rusisë

12:01 Parlamenti hungarez i heq imunitetin Peter Magyar dhe dy ish-ministrave të Orban

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

11:47 Protestë në Maliq, banorët: Po na marrin ujin për fshatin tjetër

11:46 Vrasja e Egli Progës, të akuzuarit kërkojnë gjykim të shkurtuar! Shtyhet për në tetor seanca

TESTIM

Ai ngriti shqetësimin edhe për pasojat që mund të ketë ndryshimi i hartës administrative për qytetarët, veçanërisht në zonat ku distancat me qendrat e bashkive janë të mëdha.

“Jemi të mbaruar fare. Njësisë vendose po ju bien tavanet. Do marrë qytetari dang dang autobusin 2 orë, për të shkuar në bashki të mbajë radhën, e jo më të zgjidhë gjë. Pres qafën unë po e shkel kryetari i bashkisë territorin. Do merret ai kryetar me gardhin?”, tha Korreshi.

Mazhoranca ndërkohë këmbëngul se do të vijojë me procedurën për variantin e saj me 46 bashki, ndërsa opozita kërkon që përpara miratimit të zhvillohet një tjetër proces konsultimi për alternativën me 100 bashki.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

POLITIKË | VENDI

Bardhi pas deklaratës së Ramës për Hysenin: Dil dhe jep llogari

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka reaguar pas deklaratave të kryeministrit Edi Rama për zhvillimet e fundit në vend, duke kërkuar...

12:14 | 28/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

Ambasadorja e BE: Një demokraci nuk vlerësohet vetëm si bëhen zgjedhjet, por dhe te roli i Kuvendit

Ambasadorja e BE, Sofia Moreira De Sousa ka mbajtur këtë të hënë fjalën e saj në konferencën Ndërparlamentare mes përfaqësues të institucioneve shqiptare, Parlamentit European...

11:35 | 28/09/2026

LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

“Luaj me gangsterin rus apo me lodrat kineze?”, Rama: Vendet kandidate duhet të jenë rreth tavolinës së BE-së

Kryeministri Edi Rama ka kërkuar që Bashkimi European të marrë në kohë vendimet politike për zgjerimin, ndërsa vlerësimi i secilit vend kandidat të vijojë më...

11:26 | 28/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: